



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 18.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 16.07.2025, të parashtruar nga operatori ekonomik Flamuri V SHPK Malishevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet pjesërisht e bazuar**, kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik Flamuri V SHPK Malishevë, e datës 16.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1 kundër *Vendimit të AK –së*, të datës 11.07.2025, të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Anulohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1, dhe

Anulohet Vendimi i AK për anulim të procedurës për Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik Flamuri V SHPK Malishevë, me 16.07.2025, ka parashtruar ankesë lidhur me **vendimin për shpërblim me kontratë për Llot 1** dhe **vendimin për anulim të procedurës për llot 2** të datës 11.07.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues, me datë 18.07.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi i juaj ankimorë se oferta e juaj për llot 2 që është në tërësi e përgjegjshme, nuk qëndron sepse te dëshmia 3 është cek ndër të tjera që: ...”të gjitha ato mjete që paraqiten me fatur të blerjes duhet të kenë të bashkangjitur edhe dudin doganor”.

Ne si Autoritet Kontraktues, konkretisht komisioni vlerësues nuk e ka pasur obligim që të del në teren për verifikim por ju ka mjaftuar dokumentacioni i ofruar nga ju dhe nuk është ndryshuar asnjë kërkesë e Dosjes së tenderit siq e keni cek ju në kërkesen për rishqyrtim dhe nuk kemi kërkuar më shumë se që është kërkuar në FTD dhe DT.

Lidhur me pretendimin tjetër rreth deklaratës nën betim, ju informojmë se deklaratat nën betim të grupit të operatoreve ekonomik të propozuar për kontratë janë të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi.

Sa i perket pretendimit tuaj lidhur me inxhinierin e ndertimtarise drejtimi konstruktiv, ju njoftojme qe OE i propozuar per kontrate ka kete inxhinier me drejtim “Ndertimtari dhe infrastruktural specializimi Inxhinieri Strukturore dhe inxhinieria strukturore eshte e njejte me konstruktiv dhe nvalet nga univeristet se si e specifikon, per kete mund te konsultoheni edhe me universitetin perkates per info shtese ju si OE, Inxhinieria strukturore apo konstruktiv ka te beje me degen e inxhinierise civile dhe mirret me projektimin, analizen dhe ndertimin e strukturave te ndryshme dhe objekteve tjera inxhinierike.

Lidhur me CV e gjeodetit, edhe ky pretendim nuk qendron pasi ne si AK kemi kerkuar qe Stafi profesional te deshmohet me Diplome dhe CV, pra, nuk kemi cek qe cv te skanohet nga origjinali apo kopja dhe nuk mund te kerkojme nga operatoret ekonomik diqka qe nuk e kemi kerkuar ne dosje te tenderit dhe njoftim per kontrate.

Ankesa e juaj rreth planit dinamik nuk qendron pasi qe ne FTD dhe Dosje te tenderit nuk e kemi kerkuar si kriter planin dinamik.

Rreth marreveshjes me Asphalt Group nga operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate dhe nga ju, as ky pretendim nuk qendron pasi qe per llot 1 paisja “Finisher” nuk ka qene kerkese ndersa llot 2 e kemi anuluar pikerisht per kete paisje.

Te deklarata nen betim e OE Arching group konkretisht nenshkrimet e pronarit, dhe nenshkrimet e punetoreve te kontratat, per ne si AK jane te plotesuara sipas ligjit dhe nuk paraqesin ndonje gabim.

Sa i perket pretendimit tuaj lidhur me kamionet ju njoftojme qe ky pretendim eshte pjesisht i bazuar.


AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit, bazuar në atë që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Bekim Shabani


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit